KËSHILLA SIGURIE

©I përshtatur nga EUROPOL

Si të parandaloni infektimin e pajisjeve tuaja elektronike nga Ransomware

Ransomware është një lloj malware që bllokon kompjuterin tuaj dhe pajisjet mobile ose kodon dokumentët tuaj, duke kërkuar një pagesë shpërblimi brenda një afati të caktuar.

Mund të shkarkohet përmes përditësimeve të rreme të aplikacioneve ose duke vizituar faqet e internetit të kompromet uara.

Është një mashtrim i krijuar për të gjeneruar fitime të mëdha për grupet e organizuara kriminale. Për të parandaluar dhe minimizuar efektet e Ransomware, këshillohet të merrni masat e mëposhtme:

Çfarë duhet të bëni

KRYENI PËRDITËSIME TË RREGULLTA

Shumë malware janë si rezultat i sulmuesve që shfrytëzojnë vulnerabilitete në software (shfletuesit e internetit, sistemet operative, etj.). Mbajtja e tyre e përditësuar mund të ndihmojë për t'i mbajtur pajisjet dhe dokumentet tuaj të sigurt.

PËRDORNI NJË ANTI-VIRUS.

Instaloni dhe mbani të përditësuar një program antivirusi (AV) së bashku me firewall në pajisjet tuaja. AV mund të ndihmojë në ruajtjen e kompjuterit tuaj nga malware .

SHFLETONI DHE SHKARKONI SOFTWARE VETËM NGA FAQE TË BESUESHME.

Përdorni burime zyrtare dhe faqe interneti të besueshme për të mbajtur software-in tuaj të përditësuar me versionet më të fundit të sigurisë.

KRYENI BACKUP RREGULLISHT TË TË DHËNAVE TË RUAJTURA NË KOMPJUTERIN TUAJ.

Një backup i plotë do t'ju kursejë shumë kohë dhe para kur të riktheni të dhënat tuaja. Edhe nëse prekeni nga një sulm Ransomware, do jeni në gjendje të aksesoni skedarët tuaj personal(fotografitë, listat e kontakteve, etj) nga një kompjuter tjetër.

RAPORTONI.

Nëse jeni viktimë e Ransomware, raportojeni menjëherë. Sa më shumë informacion t'u jepni autoriteteve, aq më shpejt mund të ndërmerren masa.

KONSULTOHUNI ME OFRUESIN TUAJ TË ANTIVIRUSIT SE SI TË ZHBLLOKONI DHE HIQNI INFEKSIONIN NGA PAJISJA

Ka shumë webfaqe dhe blogje zyrtare me udhëzime se si të hiqni në mënyrë të sigurt këtë lloj malware nga pajisjet tuaja elektronike.

Çfarë nuk duhet të bëni

MOS KLIKONI NË LINQE TË DYSHIMTA

Ajo që duket si një reklamë ose imazh i padëmshëm mund t'ju ridrejtojë në faqen e internetit nga ku shkarkohet një software keqdashës. E njëjta gjë mund të ndodhë kur hapni bashkëngjitjet në emailet e marra nga burime të panjohura.

MOS INSTALONI APLIKACIONE MOBILE NGA OFRUES/BURIME TË PANJOHUR.

Gjithmonë shkarkoni vetëm nga burime zyrtare dhe të besueshme.

MOS MERRNI ÇDO GJË SI TË MIRQENË

Nëse një faqe interneti ju paralajmëron për një software të vjetëruar të instaluar në kompjuterin tuaj, mos i besoni plotësisht. Është vërtet e lehtë për sulmuesit të falsifikojnë logot e kompanive dhe softwareve.
Një kërkim i shpejtë në internet mund t'ju tregojë nëse software-i juaj është vërtet i vjetëruar.

MOS INSTALONI SOFTWARE TË PANJOHUR.



Mos instaloni programe ose aplikacione në kompjuterin tuaj nëse nuk e dini se nga vijnë ato. Disa programe të instaluara përpiqen të vjedhin të dhëna personale

MOS KONSIDERONI KRYERJEN E CFARËDO PAGESE SI ZGJIDHJE KUNDREJT SULMEVE RANSOMWARE.

Pagesa nuk garanton që problemi juaj do të zgjidhet dhe se ju do të jeni në gjendje të aksesoni përsëri dokumentet tuaja dhe se informacionet tuaja nuk do të shperndahen. Përveç kësaj, ju do të mbështesni sulmuesit kibernetikë dhe financimin e aktiviteteve të tyre të paligjshme.